



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 557/25 Dt. 18.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik i plotësuar me rregulloren 002/2024 për prokurim publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndryshimeve në projekt, punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konform kërkesës së Operatorit Ekonomik dhe Raportit të Organit Mbikëqyrës, për lejimin e ndryshimeve në projekt (kolaudim të sasive), lejimin e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi dhe restaurimi i kullës në Gjonaj- Komuna dhe QRTK”, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen ndryshimet në projekt, punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 14.205.35 € (katërbëdhjetë mijë e dyqind e pesë euro e tridhjetë e pesë cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës, nr. prok. 622-24-3341-5-2-1 me OE “Albi Company” shpk dhe “AGE Group” shpk.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 54672.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

